



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 1352 Më 20.04.2022
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC



8/4/2022

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Raport i Punës –TM1/2022

Erhan Morina

KOMUNA RAHOVEC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



**Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism**

DATË /A:	08.04.2022
PËR/ZA/TO :	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	z.Erhan Morina, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i punës për periudhën janar-mars 2022



DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës.

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planifikimin e punës për vitin 2022. Në kuadër të DEZHT, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar shumë aktivitete.

Aktivitetet e drejtorisë

Gjatë muajit janar, aktivitetet tona kanë qenë kryesisht të karakterit informues, ku janë vizituar projektet që janë realizuar nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në vitin 2021 dhe projekte të tjera që janë në proces.

Në periudhën janar-mars janë zhvilluar takime të ndryshme ku në kuadër të saj kemi organizuar takim me AZHR-në, janë diskutuar temat e dy projekteve që i kemi në proces me bashkëpunim me Bashkimin Evropian.

Po ashtu në këtë kohë janë organizuar takime të ndryshme me biznese të cilat operojnë në komunën e Rahovecit.

Takim pune në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), ku është diskutuar financimi i zonës ekonomike në fshatin Optrushë.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Takim pune në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, qëllimi i takimit ka qenë informimi për thirrjet për grante që do të hapë MZHR.

Në mujain shkurt, së bashku me Kryetarin z. Smajl Latifi, kemi pritur në takim z. Fikrim Damka, Ministër i Zhvillimit Rajonal, ku është diskutuar rritja e bashkëpunimit në mes të MZHR-s dhe Komunës së Rahovecit si dhe informimi rreth aplikimit për grante për vitin 2022.

Kemi marrë pjesë në panairin e punës në Suharekë me temën: Përgaditja e të rinjve për tregun e punës, panair i organizuar nga AZHR. Në këtë panair kan marr pjesë 5 kandidatë nga Komuna e Rahovecit.

Në muajin mars, është publikuar lista e përfitueseve nga Organizata Help, ku 60 aplikant nga komuna e Rahovecit, të cilët kanë aplikuar për grante në vitin 2021, kanë kaluar fazën e parë të përzgjedhjes.

Në muajin mars, kemi aplikuar për grante në MZHR. Në këtë thirrje, kemi aplikuar me dy projekte:

- 1.Rregullimi i sheshit në qendër të qytetit dhe
2. Ndërtimi i qendrës për magazinimin e produkteve bujqësore.

Poashtu gjatë muajit mars, kam marrë pjesë në sesionin informues të IPA-s, ku janë diskutur thirrjet për grante të cilat do të jepen nga Bashkimi European.

Agjencia për Zhvillim Rajonal, në kordinim me Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ka organizur sesion informues, lidhur me skemën e granteve që ka hapur MZHR për bizneset.

Në muajin mars Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ka pasur dy pika të rendit ditës në asamblenë komunale.

- 1.Draft Rregullorja për menaxhimin e aseteve jo financiare dhe inventari i pa përdorshëm i Komunës. Ky draft rregullore ka marr miratimin e anëtareve të kuvendit të Komunës së Rahovecit.
2. Informatë mbi menaxhimin e aseteve jo financiare komunale, për vitin 2021.

1.1 Investimiet Kapitale

Në periudhën janar –mars të vitit 2022, janë zhvilluar punime në tregun ditor në Ratkoc, ku është bërë kubëzimi i pjesës së mbetur, si dhe montimi i 46 tezgave për shitje.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Po ashtu te projekti “Shtëpia e të Moshuareve” janë vendosur shtyllat elektrike, është nënshkruar marrëveshja me pronarin e “Restaurantit Bjeshka” për kyqje në trafo.

Në kuadër të mirëmbajtjes është rifunksionalizuar shtegu i ecjes te vendi i quajtur “Zhdrella”, i cili kishte pësuar dëmtime nga vërshimet.

1.2 Sektori për Ekonomi

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar të gjitha subjektet afariste prej librit kryesor të vitit 2021 në regjistrimin e librit të vitit 2022, po ashtu në fillim të vitit 2022, është bërë kalkulimi i ngarkesave në forme elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2022.

Në tre mujorin e parë të vitit 2021 janë përgaditur aktvendimet për të gjitha bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale ku në bazë të kësaj ne kemi arritur të kemi një rritje të të hyrave .

Të hyrat dhe ngarkesa në taksë komunale;

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë komunale, periudha janar-mars 2022	19,895.00 €
2	Saldo janar-mars 2022	645,876.49 €

1.3 Sektori për Zhvillim;

Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, aktualisht i menaxhon tridhjetë e gjashtë (36) kontrata, nga këto njëzetënjë (21) lokale afariste, dhjetë (10) objekte afariste dhe tre (3) hapësira të jashtme.

Poashtu në periudhën janar-mars 2022, pëlqime të punës janë lëshuar gjithsej 26 (njëzet e gjashtë).

- Të hyrat nga qiraja për periudhën janar-mars dhe saldoja është paraqitur në tabelën më poshtë:

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiraja për periudhën janar- mars 2022	13,079.25 €
2	Saldo e qirasë për periudhën janar- mars 2022	16,816.02 €

1.4 Zyra e QKRB-së

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës. Evidenca e regjistrimit të bizneseve të komunës së Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-ës, mbahet në mënyrë të rregullt.

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar-mars 2022

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të regjistruara B.I	26
2	Biznese të regjistruara Sh.P.K	12
3	Biznese të regjistruara L.L.C	3
4	Biznese të shuara	8
5	Ndryshim biznesi	40
6	Informatë biznesi	21
7	Çertifikatë N.U.I	55
8	Vërtetime	17
9	Konfirmim	1
10	Certifikat e dëmtuar	1
11	Ndryshim tipi biznesi	2
	Gjithsejtë	195

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

1.5.Menaxhimi i asteteve komunale

Spektori për asete komunale ka regjistruar me kohë të gjitha transaksionet e vitit 2021, ndërsa për vitin 2022, për periudhën janar-mars, nuk ka pasur regjistrime për arsye të lëshimit me vonesë të sistemit SIMFK.

Gjatë periudhës janar-mars zyra për menaxhimin e aseteve komunale, ka propozuar dhe ka hartuar projekt rregulloren “Menaxhimi i pasurisë jo financiare dhe inventari i përdorshëm i Komunës”. Kjo rregullore ka kaluar të gjitha fazat ligjore, duke përfshirë konsultimin publik, miratimin në kuvend dhe tani jemi në fazën e miratimit nga MAPL.

Poashtu në TM1, zyra për menaxhimin e aseteve komunale, ka mbajtur pikë informuese në Kuvend mbi menaxhimin e aseteve jo financiare për vitin 2021.

1.6.Spektori i Turizmit

Zyra për Informacione Turistike, gjegjësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e muajit janar-mars, 2022 si në vijim:

Janë mbajtur takime me organizatën e UNDP-së në lidhje me projektin për Programin Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 2, ReLOad2, ku Komuna e Rahovecit, është njëra nga komunat e përzgjedhura.

Mbajtje kontakti me organizatën Help-Gjermane me seli në Prishtinë; Informimi nga organizata në fjalë për aplikuesit të cilët kanë arritur të kalojnë në listën e ngushtë të aplikimeve.

Takim me SwissContact në Kosovë, tema: implementimi i projektit “Nxitja e punësimit dhe mundësitë për zgjerim të punësimit” objektivi i të cilit është krijimi i vendeve të reja të punës dhe gjenerimi i të ardhurave në Kosovë, në sektorin e turizmit rural.

Pjesëmarrje përmes ZOOM në konferencën e parë rajonale të organizuar nga ReLOad2/ zyra e Sarajevës, në bashkëpunim me zyret e projektit, tema e konferencës: Shoqëria Civile dhe Qeverisja Lokale-partneritetet për demokracinë lokale në Ballkanin Perëndimor.

Informimi i bizneseve të Komunës së Rahovecit, për sesionin informues për Grante të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për biznese ekzistuese dhe për ndërmarresit e rinjë (start-up).

KOMUNA RAHOVEC

Pjesëmarrja në sesion informues në bashkëpunim me AZHR-në Jug-Prizren dhe zyrën e projekteve në Rahovec, për grante të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për biznese ekzistuese dhe për ndërmarrësit e rinjë (start-up);

Dalja në teren me organizaten Help, për të verifikuar aplikuesit të cilët janë përzgjedhur si përfitues të fazës së parë të projektit.

Me respekt!

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm